

Pritjet e bizneseve për vitin 2024 dhe mjedisi i të bërit biznes në Kosovë

Anketë me sektorin privat



Metodologjia dhe Objektivat e Pyetësorit

Metodologjia

- Realizimi: Anketë e dërguar me platformë online.
- Bizneset e targetuara: rreth 5,500 biznese.
- Periudha e anketimit: 2 Shtator 2024 – 12 Shtator 2024.
- Rezultati: 267 përgjigje të vlefshme.

Objektivat


- Të ofrojë një pasqyrë për parashikimet e bizneseve për performancën e tyre për vitin 2024.
- Të sigurojë një vlerësim nga perspektiva e bizneseve mbi faktorët e ndryshëm me ndikim në mjedisin e të bërit biznes në Kosovë.

Profili i bizneseve të anketuara


Struktura e bizneseve të anketuara sipas madhësisë (bazuar në numrin e punëtorëve), u dominua nga **bizneset e vogla dhe mikro, të cilat përfaqësuan mbi 83% të bizneseve**. Pjesa tjetër përbëhej nga biznese të mesme dhe të mëdha.

Mbi bazën e rajonit ku operojnë, shumica e bizneseve të anketuara, rreth 48.9% janë me seli në rajonin e Prishtinës, të ndjekura nga rajoni i Prizrenit me rreth 17.7% të bizneseve.

Struktura e bizneseve të anketuara sipas madhësisë




Bizneset e anketuara sipas regjionit



Profili i bizneseve të anketuara (vazhdim)

Shumica e bizneseve të anketuara (**38.6%**) operojnë në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë, pasuar nga industria përpunuese (**19.1%**) dhe ndërtimtaria (**12.7%**).


Sektorët e tjerë përfaqësohen me përqindje më të vogla, ku aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike janë veprimtari kryesore e **5.6%** të bizneseve të anketuara, ndërsa informimi dhe komunikimi për **3.7%** të tyre. Sa i përket sektorëve të tjerë të mbetur, pjesëmarrja e tyre varion nga 1.1% deri në 3.7%.



Pritjet e bizneseve për vitin 2024

Rreth **48.7%** e bizneseve të anketuara presin që qarkullimi i tyre të rritet në vitin 2024, me një mesatare të rritjes prej 22.9%. Ndërkohë, **33.3%** e bizneseve mendojnë se qarkullimi nuk do të ndryshojë. Nga ana tjetër, **18.0%** e bizneseve parashikojnë rënie të qarkullimit, me një mesatare të zvogëlimit prej 19.1%.


Bizneset gjithashtu kanë shprehur pritshmëritë e tyre lidhur me numrin e punëtorëve. Rreth **51.3%** e bizneseve të anketuara presin që numri i punëtorëve të mbetet i njëjtë në vitin 2024. Në anën tjetër, **34.5%** e bizneseve presin që numri i punëtorëve të rritet, ndërsa **14.2%** kanë pritshmëri për rënie të këtij numri.



Pritjet e bizneseve për vitin 2024 (vazhdim)

Rreth **41.6%** e bizneseve të anketuara parashikojnë të eksportojnë në vitin 2024. Nga këto biznese, rreth **65.8%** presin që eksportet e tyre të rriten me një normë mesatare prej 34.2%. Në anën tjetër, **7.2%** presin që eksportet e tyre të bien, ndërsa **27.0%** nuk parashikojnë ndryshime në nivelin e eksportit.

Sa i përket investimeve, **34.5%** e bizneseve të anketuara parashikojnë një rritje të tyre në vitin 2024. Ndërkohë, **52.8%** e bizneseve nuk presin ndonjë ndryshim në nivelin e investimeve, ndërsa **12.7%** parashikojnë një rënie.




Mjedisi i të bërit biznes


Bizneset e anketuara kanë vlerësuar mjedisin e të bërit biznes në Kosovë në një shkallë nga 1, që do të thotë aspak i favorshmëm, në 5, që do të thotë shumë i favorshëm. **Rezultatet tregojnë se bizneset e shohin mjedisin e të bërit biznes si përgjithësisht jo shumë të favorshëm me një mesatare vlerësimi prej 2.8.**

Bizneset e anketuara vlerësuan gjithashtu politikat e Qeverisë ndaj bizneseve duke përdorur një shkallë nga 1, që do të thotë aspak mbështetëse, në 5, që do të thotë shumë mbështetëse. **Rezultatet tregojnë se bizneset i kanë vlerësuar politikat e qeverisë ndaj tyre si jo shumë mbështetëse. Përderisa 22.1% e bizneseve vlerësojnë politikat e qeverisë ndaj tyre si aspak mbështetëse, vetëm 4.5% e tyre i vlerësojnë politikat e qeverisë si shumë mbështetëse; mesatarja e vlerësimit është 2.5.**

Në një shkallë nga 1 deri në 5 si e vlerësoni mjedisin e të bërit biznes në Kosovë?



Në një shkallë nga 1 deri në 5, sa mbështetëse i konsideroni politikat e Qeverisë së Kosovës ndaj bizneseve?




Mjedisi i të bërit biznes (vazhdim)

Një e dhënë e rëndësishme në lidhje me barrierat e të bërit biznes ishte vlerësimi nga bizneset për ndikimin e 14 faktorëve në funksionimin dhe rritjen e tyre. Për ta realizuar këtë vlerësim, bizneset kanë përdorur një shkallë nga 0, që nënkupton aspak pengesë, deri në 100, që nënkupton pengesë e madhe për 14 faktorët në figurë.

Të dhënat tregojnë se tri pengesat më të mëdha, sipas bizneseve, janë **konkurrenca jo e drejtë**, **migrimi i punëtorëve** dhe **qasja në staf të kualifikuar**. Ndërsa si pengesa më të vogla janë renditur procedurat tatimore, furnizimi me ujë, dhe transporti.

A mund të na tregoni se sa sfidues janë faktorët e mëposhtëm për funksionimin dhe rritjen e biznesit tuaj?



Shënime Përmbyllëse

- Rreth 48.7% e bizneseve parashikojnë një rritje në qarkullim në vitin 2024.
- Nga 41.6% e bizneseve që planifikojnë të eksportojnë, gati dy të tretat e tyre presin të rrisin eksportin në vitin 2024.
- Kur bëhet fjalë për numrin e punëtorëve dhe investimeve, mbi 50% e bizneseve besojnë se këta indikatorë nuk do të ndryshojnë gjatë vitit 2024.
- Bizneset e vlerësojnë mjedisin e të bërit biznes si jo shumë të favorshëm në Kosovë, ndërsa politikat e Qeverisë ndaj tyre si relativisht jo mbështetëse.
- Barrierat kryesore sipas bizneseve janë konkurrenca jo e drejtë, migrimi i punëtorëve dhe qasja në staf të kualifikuar.